



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

V E N D I M

Nr.23. Datë.03/09/2025

MBI MIRATIMIN PËR APLIKIM TEK FONDI SOCIAL PËR VITIN 2026 ME PROJEKTIN : “SHËRBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT”

Bazuar në ligjin nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr 9335 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, i ndryshuar, nenin 38 të ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, VKM 563 datë 12.08.2005”, Për përcaktimin e përgjegjësisë të Qarkut për shpërndarjen e shërbimeve të përkujdesit shoqëror”, VKM 111 datë 23.02.2018 “Për Krijimin dhe Funksonimin e Fondit Social”, Vendimin nr 224 datë 09.04.2024 ‘Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror’, VKM 321 datë 31.05.2023 ‘Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarë të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike’, Vendimit nr 1 datë 27.08.2025 të Komitetit të Vlerësimit të Nevojave dhe Planifikimit të Shërbimeve Komunitare ad- hoc, pranë Këshillit të Qarkut Korçë.

VENDOSI:

1. Miratimin për aplikim tek Fondi Social, pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2026 me projektin “Shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme të integruara për të moshuarit”, në Bashkinë Korçë, Pogradec, Maliq, Devoll, Pustec.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe buxhetit si dhe sektori i projekteve të zhvillimit.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETARI
Erjon Nexhipi

Miratuar me 17 / Vota
Vota Pro 17 / Vota
Vota Kundër 0 / Vota
Vota Abstenim 0 / Vota
Zbardhur më datë 03/09/2025

Koncept: P. Lara

Kësh. Juridik: M. Bylykbashi

Sekretar i K. të Qarkut: B. Muco





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

MBI MIRATIMIN PËR APLIKIM TEK FONDI SOCIAL PËR VITIN 2026 ME PROJEKTIN : “SHËRBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT”

Në kuadër të funksionimit të Programit të Fondit Social, monitoruar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Qarkut Korçë së bashku me Bashkinë Korçë, Pogradec, Maliq në bashkëpunim me Fondaconin “Misioni Emanuel për Zhvillim dhe Integrim” zbatojnë projektin *“Shërbime Sociale e Shëndetësore të Përshtatshme dhe të Integruara për të Moshuarit”*, i cili ka si objekt ofrimin e shërbimeve të specializuara të përkujdesit shoqëror për të Moshuarit.

Ky projekt vjen si rezultat i bashkëpunimit disa vjeçar midis aktorëve të sipërcituar, i cili ka si qëllim zgjerimin e nivelit të shërbimeve ekzistuese të përkujdesit shoqëror dhe përfituesve, të ofruara nga Qendrat Ditore të Moshës së Tretë në nivel rajonal.

Ky shërbim fillimisht ofrohej në 4 qendra ditore në Bashkinë e Korcës e më tej nëpërmjet këtij projekti u zgjerua edhe në Bashkitë Pogradec dhe Maliq, ku aktualisht ofrojnë shërbim **6 qendra** ditore për të moshuar. “Epoka e Artë”.

Qëllimi: Të moshuarit të jetojnë e të kontribuojnë me dinjitet, të përfshirë dhe jo të diskriminuar, duke realizuar potencialin e tyre në një shoqëri që i mbështet të ruajnë aftësitë funksionale e shëndetësore dhe u mundëson akses pa barriera nëpërmjet shërbimeve cilësore shëndetësore dhe sociale

Objektivat e përgjithëm të projektit përfshijnë:

- Zgjerimin dhe forcimin e sistemit ekzistues të integruar të shërbimeve të kujdesit shoqëror i aftë të sigurojë shërbime të mbrojtjes, përkujdesit, integritetit dhe përfshirjes për të moshuarit e vetmuar në përputhje me standartet kombëtare të shërbimeve të përkujdesit shoqëror si dhe planet sociale të bashkive respektive;

- Fuqizim të kapaciteteve institucionale, njerëzore, financiare, teknike të qendrave;

- Krijimin e një ambienti të përshtatshëm që mbështet dhe ndihmon të moshuarit e vetmuar për t'u integruar në shoqëri, duke ruajtur dinjitetin njerëzor, pavarësisht nga gjendja e tyre ekonomike, shoqërore, shëndetësore apo autonoma e tyre funksionale, nëpërmjet politikave vendore efektive;

Shërbime e ofruara në qendra:

Intervistimi në terren (Fillimisht u intervistuan 15-20 të moshuar / ditë, rritëm i cili u shtua në 40-48 të moshuar / ditë nga secili punonjës social, në total u intervistuan **6816** të moshuar prej të cilëve – 4857 në Korçë, 1140 në Pogradec dhe 819 në Maliq, nga këta **1480** janë të moshuar të vetmuar (1050 në Korçë, 260 në Pogradec dhe 170 në Maliq).

Vizita në shtëpi: Stafi i projektit ofron shërbime të vlefshme jo vetëm në qendrat komunitare, por edhe në shtëpitë e të moshuarve që jetojnë vetëm, duke siguruar që ata të marrin mbështetje dhe kujdes edhe jashtë ambienteve të qendrave. Ky model i shërbimit ka ndihmuar shumë në adresimin e nevojave të veçanta të të moshuarve, duke i ofruar atyre mundësinë për të marrë vizita dhe shërbime në banesat e tyre. Gjatë këtyre muajve janë vizituar **111** të moshuar në muajin janar, **318** në muajin shkurt, **151** në muajin mars, **90** në muajin prill, **120** maj **120** në muajin qershor, **229** në muajin korrik dhe **232** në muajin gusht (**vizitat nuk kane mbaruar**) në Korçë, Maliq dhe Pogradec, si pjesë e shërbimeve të drejtpërdrejta që synojnë të ofrojnë mbështetje të personalizuar për të moshuarit që, për arsye shëndetësore apo sociale, nuk kanë mundësi të ndjekin rregullisht aktivitetet në qendrat komunitare. Për çdo të moshuar të kontaktuar punonjësi social harton një raport social individual. Përveç aspektit emocional, stafi ka ofruar ndihmë konkrete në aspekte të jetës së përditshme, duke përfshirë blerjen e ushqimeve dhe produkteve bazë të nevojshme (pazari i përditshëm), kryerjen e pagesave të shërbimeve, si energjia elektrike, uji apo shërbime të tjera komunale, ndihmë në organizimin e ambientit të shtëpisë, në rastet kur është vlerësuar e nevojshme, informim mbi shërbimet sociale në dispozicion, dhe lidhje me institucionet përkatëse nëse është kërkuar ndihmë shtesë

Konsulta dhe këshillime sociale: Të moshuarit 1 herë në javë konsultohen me punonjës social për problemet emocionale e psikologjike që i shoqërojnë, kryesisht seancat e këshillimit fokusohen në izolimin e tyre social. Konsultat organizohen në grup ose individual në varësi të nevojës.

Shërbime ditore në Qendër Janë zhvilluar rregullisht aktivitete argëtuese dhe stimuluese, si lojëra tavoline (domino, shah, letra) dhe ushtrime të lehta fizike, të cilat kanë kontribuar në ruajtjen e aftësive mendore dhe fizike të të moshuarve. Krahas tyre, janë ofruar pije të ngrohta dhe freskuese si kafe, çaj dhe kakao, duke pasuruar përvojën e përditshme në qendër dhe krijuar një atmosferë të ngrohtë dhe familjare. Përmes këtij angazhimi, stafi ka vazhduar të luajë një rol thelbësor në promovimin e mirëqenies së të moshuarve dhe forcimin e lidhjeve sociale brenda komunitetit

Kujdesi dhe ndihma mjekësore: Të moshuarit marrin konsultë një herë në javë mbi kujdesin shëndetësor si dhe matjen e parametrave të thjeshta si glicemi, tension arterial etj rastet, të cilat kanë nevojë mjekësore më të specializuar janë shoqëruar nga punonjësit socialë në qendrat shëndetësore.

Organizimi i aktiviteteve argësuese dhe festive.

Asistimi nga stafi i qendrave në përdorimin e teknologjisë (rrejetëve sociale dhe platformën e-Albania si dhe shërbimet që ajo ofron).

Të rinjtë ndihmojnë të moshuarit në fusha të ndryshme duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi të reja ose të përmirësojnë njohuritë. Aktivitete të përbashkëta midis të rinjve (nga shkolla të

qytetit ose fëmijë nga qendrat ditore të fëmijëve) dhe të moshuarve. (lojëra, gatime, filma etj). Të moshuarit ndërveprojnë me të rinjtë dhe shkëmbejnë njohuritë përmes lojërave, ditëve të gatimit, leximit, kinema etj, duke promovuar vullnetarizmin dhe bashkëveprimin ndërbrezor. Të moshuarve ju ofrohet ndihmë sipas nevojave për pagesat e faturave, blerjen e ilaceve, pazareve etj

Krijimi i grupeve të ndryshme sipas interesave të të moshuarve (muzikë, gatim, punime dore etj)

Frekuentimi për vitin 2025: (Mesatarja ditore)

Qendra	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik
Korce (L12)	32	33	34	29	39	37	29
Korce (L10)	33	40	32	27	42	35	32
Korce (L 8)	43	46	41	45	46	39	35
Korce (L 15)	40	43	45	45	43	38	35
Maliq	31	32	33	32	31	30	33
Pogradec	41	43	41	40	39	40	40

Fokusi ynë është ‘Moshimi me dinjitet’, si një koncept në shoqërinë moderne, i cili nënkupton që të moshuarit të trajtohen me respekt, të vlerësohen për kontributet e tyre dhe të kenë mundësi të jetojnë një jetë të plotë dhe të kënaqshme, pavarësisht nga mosha e tyre duke ju ofruar një gamë të gjerë shërbimesh që përmirësojnë cilësinë e jetës së tyre, promovojnë mirëqënien sociale dhe shëndetësore si dhe inkurajojnë angazhimin aktiv në komunitet, kjo jo vetëm për të moshuarit të cilët janë frekuentes të qendrave, por për të gjithë ata që tashmë kanë hyrë në ‘Epokën e Artë’

Shtrirja e projektit në zonat rurale dhe dy bashkitë e tjera është qëllimi në të ardhmen, duke plotësuar qasjen rajonale në drejtim të ofrimit të shërbimit për këtë kategori.

Në këto kushte kërkohet nga Këshilli i Qarkut Korçë miratimin për aplikim tek Fondi Social për vitin 2026 këtë projekt me impakt të gjerë në rajonal.

Koncept.: P. Lora

